



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
REKTORATI

Nr. 578 Prot.

Tiranë, më 16.02.2023

VENDIM REKTORATI

Nr. 11 Datë 16.02.2023

**“MBI MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURAT E
REKRUTIMIT PËR PERSONELIN AKADEMIK, NDIHMËS-AKADEMIK
DHE ADMINISTRATIV NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS**

Në përputhje me Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 40, Statutin e UBT-së, miratuar me Urdhrin nr.279, datë 28.07.2021 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, neni 16, në mbledhjen e tij të datës 16.02.2023, Rektorati,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Rregulloren “Për procedurat e rekrutimit për personelin akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ në Universitetin Bujqësor të Tiranës”.
2. Kjo rregullore të kalojë për miratim në mbledhjen më të afërt të Senatit Akademik.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Burimeve Njerzore dhe Shërbimeve Juridike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 578/1 Prot.

Tiranë, më 23.02.2023

VENDIM SENATI

Nr. 9 Datë 23.02.2023

**“MBI MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURAT E
REKRUTIMIT PËR PERSONELIN AKADEMIK, NDIHMËS-AKADEMIK
DHE ADMINISTRATIV NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS”**

Në përputhje me Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 38, pika 1, gërma “d”, neni 3, me Statutin e UBT-së, miratuar me Urdhrin nr. 279, datë 28.07.2021 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, neni 2, pika 6, gërma “p”, neni 14, pika 3 dhe pika 14, me Vendimin e Rektoratit me Nr.11 datë 16.02.2023, në mbledhjen e tij të datës 23.02.2023, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Të miratojë Rregulloren “Për procedurat e rekrutimit për personelin akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ në Universitetin Bujqësor të Tiranës”.
2. Ngarkohen për zbatimin e kësaj rregulloreje Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike, si dhe të gjitha njësitë përbërëse të UBT-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU





UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS / AGRICULTURAL UNIVERSITY OF TIRANA

Rr. Pajsi Vodica, Kodër-Kamëz, Tiranë, Albania. / T: +35547200874 / E: info@ubt.edu.al / W: www.ubt.edu.al



MIRATOI

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Fatbardh SALLAKU



RREGULLORE

“PËR PROCEDURAT E REKRUTIMIT PËR PERSONELIN AKADEMIK, NDIHMËS-AKADEMIK DHE ADMINISTRATIV NË UNIVERSITETIN BUJQËSOR TË TIRANËS”

Miratur me Vendimin e Senatit Akademik të Universitetit Bujqësor të Tiranës,

Nr.09, datë 23.02.2023

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i standarteve dhe rregullave bazë lidhur me mënyrën, procedurën, kriteret e rekrutimit për personelin akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ në Universitetin Bujqësor të Tiranës (më poshtë UBT).

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo rregullore është mbështetur në:

1. Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
2. Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”;
3. Kodin e punës së Republikës së Shqipërisë;
4. Statutin e UBT-së, miratuar me Urdhërin nr.279, datë 28.7.2021 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, dhe
5. Rregulloret e tjera të UBT-së.

Neni 3

Parime të përgjithshme

1. Procedurat e rekrutimit për personelin akademik, ndihmës-akademik dhe administrativ të UBT-së realizohen duke respektuar parimet kryesore si më poshtë:
 - a. Shanse të barabarta;
 - b. Meritokraci;
 - c. Profesionalizëm;
 - d. Mosdiskriminim;
 - e. Proces për zgjedhje transparent dhe i drejtë;
 - f. Paanësi



Neni 4

Përkufizime

1. “Përzgjedhja” është procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për t'u punësuar në vendin e vakant nëpërmjet procedurave të konkurimit/procedurave urgjente si dhe levizjeve paralele brenda organikës së UBT të përcaktuar në këtë rregullore.
2. “Punësimi” është procesi i pranimit në punë, i fillimit dhe i vazhimit marrëdhënieve të punës ndërmjet UBT-së dhe kandidatit të përzgjedhur fitues për pozicionin vakant.
3. “Vendim emërimi” është akti me të cilin Rektori ose Administratori, në emër dhe për llogari të UBT-së, shpreh vullnetin për të marrë në punë kandidatin fitues.
4. “Komision *ad-hoc*” nënkupton Komisionin i ngritur bazuar në Statutin e UBT-së, përgjegjës për zhvillimin e procedurave për rekrutimin e kandidatëve.
5. “Ankim” mjet procedural i parashikuar në këtë rregullore dhe në aktë të tjera ligjore në fuqi, për kundërshtimin e veprimeve ose mosveprimeve të Komisioneve apo autoriteteve drejtuese.

KREU II

PROCEDURA DHE KRITERET E PËRGJITHSHME TË REKRUTIMIT

Neni 5

Shpallja e njoftimit për vendin vakant

1. Njoftimi për vendet e lira shpallet nga Rektori për personelin akademik dhe ndihmës akademik dhe nga Administratori i UBT-së për personelin administrativ.
2. Njoftimi për zhvillimin e konkursit publik për kategoritë e personelit akademik publikohet në Buletinin e Administratës Publike dhe në faqen zyrtare të internetit të UBT-së.
3. Njoftimi për zhvillimin e konkursit publik për kategorinë ndihmës akademik dhe administrativ (deri në nivelin specialist) publikohet në faqen zyrtare të internetit të UBT- së.

Neni 6

Përmbajtja e njoftimit

Njoftimi për vendin vakant të punës duhet të përmbajë:

1. një përshkrim të shkurtër të vendit të punës, pozicioni/ sektori/ drejtoria/institucioni.



2. kushtet e pranimi, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta që duhet të plotësojë kandidati për vendin përkatës të punës;
3. listën e dokumentacionit që duhet të paraqesin kandidatët;
4. afatin e dorëzimit të dokumentacionit;
5. vendin e dorëzimit të dokumentacionit nga ana e kandidatëve dhe mënyrën e konkurimit.
6. datën e publikimit të rezultateve të vlerësimit paraprak mbi minimumin e kriterëve të veçanta për pozicionin;
7. datën, vendin dhe kohën kur do të organizohet intervista;
8. fushën e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të vlerësohet kandidati;
9. mënyrën e vlerësimit të kandidatëve;
10. datën e shpalljes së rezultateve të konkurimit;
11. mënyrën e komunikimit me kandidatët dhe njoftimin e rezultateve;
12. Kur nevojitet, shpallja do të përmbajë kategorinë/klasën e pagës.

Neni 7

Dorëzimi i dokumentacionit

1. Dorëzimi i dokumentacionit të kërkuar për vendin vakant të punës do të bëhet pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike në UBT, ose nëpërmjet postës zyrtare, brenda afateve të caktuara në njoftimin e publikuar.
2. Dokumentacioni i kërkuar për procedurën e konkurimit duhet të jetë origjinal ose i noterizuar.

Neni 8

Kritere të Përgjithshme të Rekrutimit

Kriteret e përgjithshme të Rekrutimit, që duhet të plotësojnë kandidatët të cilët do të jenë subjekt i rekrutimit, e që dëshirojnë të aplikojnë për vendet vakante të shpallura për personel akademik, ndihmës akademik dhe administrativ në UBT, janë:

1. të jenë shtetas shqiptar;
2. të kenë zotësi të plotë për të vepruar;
3. të zotërojnë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
4. të jenë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
5. të zotërojnë aftësitë profesionale specifike për vendin e punës për të cilin konkurojnë;
6. të kenë aftësinë e punës në grup dhe të komunikimit profesional;



7. të mos jenë të dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një vepre penale;
8. të mos jetë marrë ndaj tyre masa disiplinore e largimit nga puna, e cila nuk është shuar sipas ligjit në fuqi.

Neni 9

Procedura e konkurimit

1. Rekrutimi në UBT realizohet me procedurë të konkurimit të hapur (publik) duke garantuar një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv.
2. Konkurimi zhvillohet në dy faza:
 - a. vlerësimi me pikë i dokumentacionit të dorëzuar nga kandidati;
 - b. intervista me gojë.


KREU III

REKRUTIMI I PERSONELIT NË UBT

Neni 10

Procedura dhe kriteret e rekrutimit të personelit akademik

1. Rekrutimi i personelit akademik bëhet me konkurs si dhe për raste urgjente dhe specifike rekrutimet mund të procedohen me kërkesë të argumentuar të drejtuesit direct. Në të gjitha rastet personeli akademik duhet të plotësojë kriteret të përgjithshme dhe kriteret të veçanta të përcaktuara në këtë rregullore.
2. Konkursi në UBT drejtohet nga një komision “ad-hoc” prej pesë anëtarësh, i përbërë në shumicë nga përfaqësues të njësive përkatëse.
3. Në komisionin “ad-hoc” do të jenë tre përfaqësues të njësive përkatëse, një përfaqësues nga Rektorati dhe një përfaqësues nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.
4. Në përputhje me këtë procedurë, njësia kryesore ku do të punësohet personeli akademik me kohë të plotë, ngre një komision “ad-hoc” të përbërë nga tre anëtarë të tij, të cilët duhet të kenë përvojë jo më pak se pesë vite punë në UBT dhe ia përcjell Rektorit të UBT.
5. Propozimin për anëtarët e komisionit “ad-hoc”, drejtuesi i njësive kryesore, ia përcjell për miratim Rektorit të UBT-së.
6. Rektori i UBT-së në bazë të propozimit të njësive kryesore dhe atij të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore të UBT-së për përfaqësuesin e tyre në komisionin “ad hoc”, pasi cakton edhe përfaqësuesin e rektoratit, miraton komisionin “ad-hoc”. Në cilësinë e Kryetarit të Komisionit do të jetë drejtuesi i njësive kryesore.



7. Komisioni “ad-hoc” vlerëson dhe rendit kandidatët për vendin e punës në fjalë dhe raportin përfundimtar ia përcjell Rektorit të UBT-së.
8. Rektori i UBT-së, pas përfundimit të afateve të ankimit, merr vendim për shpalljen e kandidatit fitues dhe lidhjen e kontratës së punës.
9. Konkursi mund të zhvillohet nëse merr pjesë vetëm një kandidat në rastet kur njoftimi për shpalljen e vendit vakant është publikuar 1 herë dhe është anuluar për arsye të mungesës së numrit të kërkuar të kandidatëve (më pak se 2). Në këtë rast procedura e konkursit mund të zhvillohet brenda kriterëve të përcaktuara edhe me një kandidat.
10. Në rast se pas shpalljes së procedurës për vëndin vakant nuk është paraqitur asnjë kandidat, procedura mund të rishpallet duke rishikuar kriteret. Në rastin kur pas shpalljes së procedurës për vëndin vakant është paraqitur vetëm 1 kandidat, procedura rishpallet me të njëjtat kriteret.
11. Kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përgjithshme, kriteret e veçanta si dhe kandidatët që shpallen jo fitues nga Komisioni, njoftohen individualisht nëpërmjet postës elektronike (email) nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.
12. Lista me dokumentat e kërkuara i bashkëngjitet kësaj rregulloreje në aneksin nr. 1.
13. Kriteret e veçanta të vlerësimit të kandidatëve sipas pozicionit përkatës janë bashkëngjitur kësaj rregulloreje në aneksin nr. 2.

Neni 11

Kriteret e veçanta të rekrutimit të personelit akademik

1. Kriteret e veçanta të punësimit të personelit akademik me kohë të plotë përcaktohen nga njësia bazë, konfirmohen nga njësia kryesore dhe miratohen pranë Rektorit të UBT-së.
2. Nota mesatare minimale për t’u punësuar si personel akademik me kohë të plotë në UBT, duhet të jetë mbi 8 e të dy cikleve të studimit (bachelor dhe master i shkencave).
3. Nota mesatare minimale për t’u punësuar si personel akademik i ftuar në UBT duhet të jetë mbi 8 e të dy cikleve të studimit (bachelor dhe master i shkencave).

KREU IV

REKRUTIMI I PERSONELIT NDIHMËS AKADEMIK

Neni 12

Procedura dhe kriteret e rekrutimit të personelit ndihmës akademik pjesë e njësive

kryesore



1. Rekrutimi i personelit ndihmës akademik bëhet me konkurs si dhe për raste urgjente dhe specifike rekrutimet mund të procedohen me kërkesë të argumentuar të drejtuesit direkt. Në të gjitha rastet personeli ndihmës akademik duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta të përcaktuara në këtë rregullore.
2. Kriteret e veçanta të punësimit të personelit ndihmës akademik, me kohë të plotë, propozohen nga njësia bazë së cilës ky personel i shërben, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, konfirmohen nga njësia kryesore ku ai do të shërbejë dhe miratohen nga Rektori i UBT-së.
3. Në përputhje me këtë procedurë njësia bazë ku do të punësohet personeli ndihmës akademik, ngre një komision “ad-hoc” të përbërë nga tre anëtarë të tij dhe ia përcjell drejtuesit të njësisë kryesore.
4. Në komisionin “ad-hoc” do të jenë tre përfaqësues të njësisë përkatëse, një përfaqësues nga rektorati dhe një përfaqësues nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore që miratohen nga Rektori.
5. Kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përgjithshme, kriteret e veçanta si dhe kandidatët jo fitues, njoftohen individualisht nëpërmjet postës elektronike (email) nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.
6. Komisioni “ad-hoc” vlerëson dhe rendit kandidatët për vendin e punës në fjalë dhe përcjell raportin përfundimtar Rektorit të UBT-së.
7. Rektori i UBT-së, pas përfundimit të afateve të ankimit, merr vendim për shpalljen e kandidatit fitues dhe lidhjen e kontratës së punës.
8. Konkursi mund të zhvillohet nëse merr pjesë vetëm një kandidat në rastet kur njoftimi për shpalljen e vendit vakant është publikuar 1 herë, dhe është anuluar për arsye të mungesës së numrit të kërkuar të kandidatëve, procedura e konkursit mund të zhvillohet brenda kriterëve të përcaktuara edhe me një kandidat.
9. Lista me dokumentat e kërkuara i bashkëngjitet kësaj rregulloreje ne aneksin nr. 1.
10. Kriteret e veçanta të vlerësimit të kandidatëve sipas pozicionit përkatës janë bashkëngjitur kësaj rregulloreje në aneksin nr. 2.

Neni 13

Procedura dhe kriteret e rekrutimit të personelit ndihmës akademik pjesë e strukturave në nivel universiteti

1. Rekrutimi i personelit ndihmës akademik bëhet me konkurs, bazuar në kriteret e përgjithshme dhe kriteret e veçanta.



2. Kriteret e veçanta të punësimit të personelit ndihmës akademik, me kohë të plotë, propozohen nga sektori/dega/drejtorja së cilës ky personel i shërben, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, konfirmohen nga Drejtoria e Burimeve Njerzore dhe miratohen nga Rektori i UBT-së.
3. Në përputhje me këtë procedurë sektori/dega/drejtorja ku do të punësohet personeli ndihmës akademik cakton një anëtarë që do të jetë pjesë e komisionit të rekrutimit dhe ia përcjell Drejtorise se Burimeve Njerzore.
4. Në komisionin “ad-hoc” do të jenë një përfaqësues nga sektori/dega/drejtorja, një përfaqësues nga rektorati (Zv.Rektori për mësimin) dhe një përfaqësues nga Drejtoria e Burimeve Njerzore që miratohen nga Rektori.
5. Kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përgjithshme, kriteret e veçanta si dhe kandidatët jo fitues, njoftohen individualisht nëpërmjet postës elektronike (email) nga Drejtoria e Burimeve Njerzore.
6. Komisioni “ad-hoc” vlerëson dhe rendit kandidatët për vendin e punës në fjalë dhe përcjell raportin përfundimtar Rektorit të UBT-së.
7. Rektori i UBT-së, pas përfundimit të afateve të ankimit, merr vendim për shpalljen e kandidatit fitues dhe lidhjen e kontratës së punës.
8. Lista me dokumentat e kërkuara i bashkëngjitet kësaj rregulloreje në aneksin nr.4.
9. Kriteret e veçanta të vlerësimit të kandidatëve sipas pozicionit përkatës janë bashkëngjitur kësaj rregulloreje në aneksin nr.4.

KREU V

REKRUTIMI I PERSONELIT AKADEMIK TË FTUAR

Neni 14

Procedura dhe kriteret e rekrutimit të personeli akademik të ftuar

1. Për nevoja konkrete të mësimdhënies ose të kërkimit shkencor, me kërkesë të departamenteve dhe miratim të Dekanit, i propozohet Rektorit të ftojë për veprimtari mësimore apo kërkimore, personel akademik, sipas kërkesave të vendit të punës pasi janë llogaritur ngarkesat mësimore, përpara fillimit të vitit të ri akademik.
2. Përzgjedhja e këtij personeli duhet të kombinojë nevojën e njësisë për mësimdhënie apo kërkim shkencor me kualifikimet e tyre.



3. Proçedura e publikimit të njoftimit për konkurs bëhet në faqen zyrtare të UBT-së.
4. Kriteret e përgjithshme dhe dokumentacioni i kërkuar është i njëjtë me atë të personelit akademik me kohë të plotë të përcaktuar në këtë rregullore.
5. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në njoftimin e publikuar pranë Drejorisë së Burimeve Njerëzore ose nëpërmjet postës zyrtare.
6. Pas përfundimit të afatit të dorëzimit të dosjeve, Drejoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike bën vlerësimin përfundimtar të dosjeve sipas kritereve të shpallura dhe i dërgon Rektorit:
 - a) Raportin me kandidatët e kualifikuar, të cilët kanë përmbushur kriteret e shpallura.
 - b) Raportin me kandidatët e skualifikuar, të cilët nuk i kanë përmbushur kriteret e shpallura, shoqëruar me komentet përkatëse.
7. Rektori listen e kandidatëve të kualifikuar e dërgon për shqyrtim pranë Dekanateve të Fakulteteve, të cilët brenda 3 ditëve duhet të dërgojnë për miratim përfundimtar pranë Rektorit listen me emrat e përzgjedhur si personel akademik të ftuar së bashku me ngarkesën mësimore përkatëse.
8. Rektori, pasi shqyrton listat e përzgjedhura nga Dekanatet e Fakulteteve, merr vendim për shpalljen e listës me emrat e kandidatëve fitues.
9. Lista me emrat e kandidatëve fitues publikohet në faqen zyrtare të internetit të UBT- së.

KREU VI

REKRUTIMI I PERSONELIT ADMINISTRATIV

Neni 15

Procedura dhe kriteret e rekrutimit të personelit administrativ

1. Rekrutimi i personelit administrativ bëhet me konkurs si dhe për raste urgjente dhe specifike rekrutimet mund të procedohen me kërkesë të argumentuar të drejtuesit direkt. Në të gjitha rastet personeli administrativ duhet të plotësojë kritere të përgjithshme dhe kritere të veçanta të përcaktuara në këtë rregullore.
2. Kriteret e veçanta të punësimit të personelit administrativ, me kohë të plotë, propozohen nga sektori/dega/drejtoria së cilës ky personel i shërben, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, konfirmohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe miratohen nga Administratori i UBT-së.
3. Konkursi i punësimit të personelit administrativ në UBT drejtohet nga një komision “ad-hoc”.
4. Në përputhje me këtë proçedurë sektori/dega/drejtoria ku do të punësohet personeli administrative cakton një anëtarë që do të jetë pjesë e komisionit të rekrutimit dhe ia përcjell Drejtorisë se



Burimeve Njerzore.

5. Në komisionin “ad-hoc” do të jenë një përfaqësues nga sektori/dega/drejtoria, një përfaqësues i caktuar nga Administratori dhe një përfaqësues nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.
6. Kandidatët që nuk plotësojnë kriteret e përgjithshme, kriteret e veçanta si dhe kandidatët jo fitues, njoftohen individualisht nëpërmjet postës elektronike (email) nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.
7. Komisioni “ad-hoc” vlerëson dhe rendit kandidatët për vendin e punës në fjalë dhe përcjell raportin përfundimtar Administratorit të UBT-së.
8. Administratori i UBT-së, pas përfundimit të afateve të ankimit, merr vendim për shpalljen e kandidatit fitues dhe lidhjen e kontratës së punës.
9. Lista me dokumentat e kërkuara i bashkëngjitet kësaj rregulloreje në aneksin nr.1, 2 ose 3.
11. Kriteret e veçanta të vlerësimit të kandidatëve sipas pozicionit përkatës janë bashkëngjitur kësaj rregulloreje në aneksin nr.1, 2 ose 3.

Neni 16

E drejta e ankimit

1. Çdo kandidat ka të drejtë të paraqesë ankesë me shkrim pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore mbi mënyrën e zhvillimit dhe rezultatin përfundimtar të konkurimit brenda 5 ditëve punë nga dita e marrjes së njoftimit individual mbi rezultatet e konkursit nëpërmjet postës elektronike.
2. Për shqyrtimin e ankesave Rektori ngre një komision të posaçëm të përbërë nga 3 anëtarë, i cili duhet të shprehet brenda 3 ditëve punë.
3. Në përfundim, Rektori merr vendim për pranimin ose rrëzimin e ankesës, vendim i cili i njoftohet kandidatit nëpërmjet Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.
4. Mbas kalimit të afatit kohor të paraqitjes së ankesave apo shqyrtimit të tyre, Rektori merr vendim emërimi për fillimin e marrëdhënieve të punës.

Neni 17

Regjistri i personelit

1. Drejtoria e Burimeve Njerëzore mban regjistrin themeltar të personelit, i cili përmban të dhënat profesionale dhe të karrierës për çdo punonjës.



2. Drejtoria e Burimeve Njerëzore mban dosjet personale të punonjësve dhe dokumentet e punësimit për punonjësit e të gjitha njësive të strukturës organizative si në nivel të njësive kryesore dhe të të gjithë strukturave të tjera në varësi të Universitetit Bujqësor të Tiranës.
3. Dokumentacioni i përcaktuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, ruhet dhe administrohet nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Neni 18

Ndryshimi, zëvendësimi, shtimi dhe shfuqizimi i dispozitave

Dispozitat e kësaj rregulloreje do të ndryshohen, shtohen dhe shfuqizohen me vendim të Senatit Akademik të UBT-së.

Neni 19

Dispozitat kalimtare dhe të fundit

Procedurat e rekrutimit për personel akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të nisura përpara hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje do të zhvillohen sipas procedurave dhe kritereve të parashikuara nga Rregullorja nr.2843 Prot, datë 31.12.2018 “Për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ në UBT.”

Neni 20

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj nga Senati Akademik i Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Me miratimin e kësaj rregullore nga Senati Akademik, shfuqizohet Rregullorja nr.2843 Prot, datë 31.12.2018 “Për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ në UBT.”



ANEKSI I

LËNDA: Kriteria të vlerësimit të kandidatëve për konkurim për vend të lirë pune për personel akademik në “ Dep” _____ ”

pranë Fakultetit të _____

B. KATEGORIA: “Asistent Lektor”

I. KRITERE TE PËRGJITHSHME

I	KRITERE ELIMINUESE
1	Të jetë diplomuar në sistemin me kohë të plotë në të dy nivelet: Bachelor dhe Master Shkencor. Preferencat për Diplomant përcaktohen nga departamentet përkatës, brenda dhe jashtë vendit). Në rastet kur kandidati ka notën mesatare 10.0, ai rekrutohet pa konkurim.
2	Të kenë notë mesatare të shkollës së lartë mbi 8.00, si mesatare të dy cikleve të studimit: Bachelor dhe Master Shkencor. Për çdo 0.1 note më shumë se 8.00, shtohet me 4 pikë në vlerësim. Në asnjë rast kandidati nuk duhet të ketë note mesatare më të ulët se 7 për çdo cikël studimi. Në rastet kur kandidati ka notën mesatare 10.0, ai rekrutohet pa konkurim. Mosha e pranuar në konkurim është deri në 30 vjeç.
<i>Shënim: Në rast mosplotësimi të kriterëve më sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.</i>	

II. KRITERE TE VEÇANTA

I	KRITERE PËR VLERËSIMIN NË (PIKË) DHE RENDITJEN E KANDIDATËVE	Vlerësimi (pikë)
1	Shkollim dhe kualifikim të mëtejshëm:	
	Master jashtë vendit (brenda fushës që konkurron)	5
2	Përvojë pune në fushën e studimit dhe mësimdhënie	



	Për çdo vit eksperiencë në mësimdhënie në universitet (kohë e plotë dy pikë)	2
	Për çdo vit eksperiencë në mësimdhënie në universitet (pedagog i ftuar)	1
3	Kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit	
	Kurs kualifikimi brenda vendit në fushën e profesionit, i vërtetuar me dëshmi (1 kurs = 1 pikë)	1
	Kurs kualifikimi jashtë vendit në fushën e profesionit i vërtetuar me dëshmi (1 kurs = 2 pikë)	2
4	Aftësimi në programe kompjuterike (me dëshmi përkatëse)	2
5	Njohuri të gjuhëve perëndimore (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht, dhe spanjisht) e vërtetuar me dëshmi nga kurset internac. (nuk njihet asnjë dëshmi tjetër jashtë këtij kriteri)	
	Gjuhë angleze, niveli C1	20
	Gjuhë të tjera. Niveli ekuivalent me C1 në gjuhën Angleze (numri maksimal i tyre është 4, në gjuhët më poshtë: italisht, gjermanisht, frëngjisht, dhe spanjisht).	10
6	Referime në:	
	Sesione & konferenca shkencore&kongrese brenda vendit, numër pjesëmarrjesh me botim në proceedings (autor i parë)	5
	Sesione shkencore, konferenca shkencore&kongrese jashtë vendit , numër pjesëmarrjesh me botim në proceedings (autor i parë)	10
TOTALI PIKËVE (70)		70 pikë
II	Intervista me gojë	30 pikë
TOTALI PIKËVE =Totali i pikëve të dosjes + totali i pikëve të intervistës		



Shënim:

- *Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Komisioni i rekrutimit bëjnë vlerësimin e dosjes sipas përcaktimeve të mesipërme.*
- *Total i pikëve të kandidatit është shuma e pikëve të vlerësimit të dosjes me pikët nga intervista me gojë.*

Kujdes & Konsideroni:

- *Konferenca ndërkombetare do të konsiderohen të gjitha ato që zhvillohen (i) jashtë shtetit me bord organizator dhe shkencor dhe proceedings nga një Universitet ose Institucionin tjetër ndërkombëtar dhe (ii) ato që organizohen në Shqipëri nga njëri nga Universitetet Publike të Tiranës (UBT, UT, UP) me bord organizator dhe shkencor dhe proceedings; që përmban titullin ndërkombëtar në të cilin marrin pjesë kërkues nga shumë vende.*
- *Në kushtet kur kandidatët kanë pikë të barabarta preferohet kandidati që ka kryer studimet (Bachelor dhe/ose Master, dhe/ose Doktoratë jashtë vendit).*
- *Në rastet kur njoftimi për shpalljen e vendit vakant është publikuar 1 herë, dhe është anuluar për arsye të mungesës së numrit të kërkuar të kandidatëve, procedura e konkursit mund të zhvillohet brenda kritereve të përcaktuara edhe me një kandidat.*



ANEKSI II

LËNDA: Krite të vlerësimit të kandidatëve për konkurim për vend të lirë pune për personel akademik në “ dep” _____ ”

pranë Fakultetit të _____

B. KATEGORIA: “Lektor”

I. KRITERE TË PËRGJITHSHME

I	KRITERE ELIMINUESE
1	Të jetë diplomuar në sistemin me kohë të plotë në të dy nivelet: Bachelor dhe Master Shkencor ose \ në Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë - DIND. Preferencat për Diplomat përcaktohen nga departamentet përkatës, brenda dhe jashtë vendit. Në rastet kur kandidati ka notën mesatare 10.0, ai rekrutohet pa konkurim.
	Të kenë notë mesatare të shkollës së lartë mbi 8.00, si mesatare të dy cikleve të studimit: Bachelor dhe Master Shkencor.
	Në pozicionin LEKTOR mund të konkurojnë kandidatët që kanë fituar gradën “DOKTOR ose Ph.D.
<i>Shënim: Në rast mosplotësimi të kriterëve më sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.</i>	

III. KRITERE TE VEÇANTA

II.	KRITERE PËR VLERËSIMIN NË (PIKË) DHE RENDITJEN E KANDIDATËVE	Vlerësimi (pikë)
1	Shkollim dhe kualifikim të mëtjshëm:	
	Doktoratë jashtë vendit (brenda fushës që kandidon)	8
2	Të kenë përvojë pune në profesion dhe në mësimdhënie:	
	Per çdo vit eksperiencë në mësimdhënie në universitet (kohë e plotë)	2
	Per çdo vit eksperiencë në mësimdhënie në universitet, pedagog i ftuar	1

3	Kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit:	
	Kurs kualifikimi brenda vendit (i vërtetuar me dëshmi ose dokument tjetër)	1
	Kurs kualifikimi jashtë vendit (i vërtetuar me dëshmi ose dokument tjetër)	2
4	Njohuri të gjuhëve perëndimore (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht, spanjisht, etj.) e vërtetuar me dëshmi nga kurset intern (nuk njihet asnjë dëshmi tjetër jashtë këtij kriteri).	
	Gjuha Angleze, Niveli C1	20
	Gjuhë e tjera, Niveli ekuivalent me gjuhën angleze C1, vlerësohen me 10 pikë	10
5	Botime:	
	Tekst mësimor të aprovuar nga departamenti përkatës (autor i parë),	5
	Artikull / artikuj shkencorë (brenda fushës) të botuar brenda vendit (autor i parë),	2
	Artikull / artikuj shkencorë (brenda fushës) të botuar jashtë vendit (autor i parë)	4
	Artikull / artikuj shkencorë (brenda fushës) të botuar jashtë vendit me faktor impakti (të indeksuar vetëm me Tomson Reuters) (autor i parë)	8
6	Referime në:	
	Sesione shkencore, konferenca, kongrese brenda vendit, numër pjesmarrjesh me botim në proceedings (autor i parë)	2
	Sesione shkencore, konferenca, kongrese jashtë vendit, numër pjesmarrjesh me botim në proceedings (autor i parë),	5
TOTALI PIKËVE 70 pikë		
I	Intervista me gojë	30 pikeve

- *Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Komisioni i rekrutimit bëjnë vlerësimin e dosjes sipas përcaktimeve të mesipërme.*
- *Total i pikëve të kandidatit është shuma e pikëve të vlerësimit të dosjes me pikët nga intervista me gojë.*

Kujdes & Konsideroni:

- *Konferenca ndërkombetare do të konsiderohen të gjitha ato që zhvillohen (i) jashtë shtetit me bord organizator dhe shkencor dhe proceedings nga një Universitet ose Institucionin tjetër ndërkombëtar dhe (ii) ato që organizohen në Shqipëri nga njëri nga Universitetet Publike të Tiranës (UBT, UT, UP) me bord organizator dhe shkencor dhe proceedings; që përmban titullin ndërkombëtar në të cilin marrin pjesë kërkues nga shumë vende.*
- *Në kushtet kur kandidatët kanë pikë të barabarta preferohet kandidati që ka kryer studimet (Bachelor dhe/ose Master, dhe/ose Doktoratë jashtë vendit).*
- *Në rastet kur njoftimi për shpalljen e vendit vakant është publikuar 1 herë, dhe është anuluar për arsye të mungesës së numrit të kërkuar të kandidatëve, procedura e konkursit mund të zhvillohet brenda kritereve të përcaktuara edhe me një kandidat.*



ANEKSI III

LËNDA:Kritere të vlerësimit të kandidatëve për konkurim për vend

të lirë pune për personel akademik në “Dep” _____”

pranë Fakultetit të _____

C. KATEGORIA: “ Profesor”

KRITERE TË PËRGJITHSHME

I.	KRITERE ELIMINUESE
1.	Të jetë diplomuar në sistemin me kohë të plotë në të dy nivelet: Bachelor dhe Master Shkencor ose në Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë - DIND. Preferencat për Diplomat përcaktohen nga departamentet përkatës, brenda dhe jashtë vendit).
2.	Të kenë notë mesatare të shkollës së lartë mbi 8.00, si mesatare të dy cikleve të studimit: Bachelor dhe Master Shkencor. Në rastet kur kandidati ka notën mesatare 10.0, ai rekrutohet pa konkurim.
3.	Në pozicionin PROFESOR mund të konkurojnë kandidatët që kanë fituar titullin “Profesor i Asociuar” ose titullin “Profesor”.
<i>Shënim: Në rast mosplotësimi të kriterëve më sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.</i>	

KRITERE TE VEÇANTA

II	KRITERE PËR VLERËSIMIN NË (PIKË) DHE RENDITJEN E KANDIDATËVE	Vlerësimi (pikë)
1	Shkollim dhe kualifikim të mëtjshëm:	



	• Titulli „PROFESOR“	10
	• Titulli „Profesor i asociuar“	5
2	Të kenë përvojë pune në profesion dhe në mësimdhënie:	
	• Për çdo vit eksperiencë në mësimdhënie në universitet (kohë e plotë)	1
	• Për çdo vit eksperiencë në mësimdhënie në universitet (pedagog i ftuar)	1
3	Kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit:	
	• Kurs kualifikimi brenda vendit (i vërtetuar me dëshmi ose dokument tjetër)	1
	• Kurs kualifikimi jashtë vendit (i vërtetuar me dëshmi ose dokument tjetër)	2
4	Njohuri të gjuhëve perëndimore (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjisht spanjisht, etj.) e vërtetuar me dëshmi nga kurset internac. (nuk njihet asnjë dëshmi tjetër jashtë këtij kriteri).	
	• Gjuha Angleze, Niveli C1	20
	• Gjuhë e tjera, Niveli ekuivalent me gjuhën angleze C1 (pavarësisht numrit)	10
5	Botime:	
	• Tekst mësimor të aprovuar nga departamenti përkatës (autor i parë)	5
	• Artikull / artikuj shkencorë (brenda fushës) të botuar brenda vendit (autor i parë)	2
	• Artikull / artikuj shkencorë (brenda fushës) të botuar jashtë vendit (autor i parë)	4
	• Artikull / artikuj shkencorë (brenda fushës) të botuar jashtë vendit me faktor impakti (të indeksuar vetëm me Thomson Reuters) (autor i parë)	8
6	Referime në:	
	• Sesione shkencore, konferenca, kongrese brenda vendit, numër pjesëmarrjesh me botim në proceedings (autor i parë)	4



	Sesione shkencore, konferenca, kongrese jashtë vendit, numër pjesmarrjesh me botim në proceedings (autor i parë)	4
	TOTALI PIKËVE 70 pikë	
II	Intervista me gojë	30

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Komisioni i rekrutimit bëjnë vlerësimin e dosjes sipas përcaktimeve të mesipërme.
- Total i pikëve të kandidatit është shuma e pikëve të vlerësimit të dosjes me pikët nga intervista me gojë.

Kujdes & Konsideroni:

- Konferenca ndërkombetare do të konsiderohen të gjitha ato që zhvillohen (i) jashtë shtetit me bord organizator dhe shkencor dhe proceedings nga një Universitet ose Institucionin tjetër ndërkombëtar dhe (ii) ato që organizohen në Shqipëri nga njëri nga Universitetet Publike të Tiranës (UBT, UT, UP) me bord organizator dhe shkencor dhe proceedings; që përmban titullin ndërkombëtar në të cilin marrin pjesë kërkues nga shumë vende.
- Në kushtet kur kandidatët kanë pikë të barabarta preferohet kandidati që ka kryer studimet (Bachelor dhe/ose Master, dhe/ose Doktoratë jashtë vendit).

Në rastet kur njoftimi për shpalljen e vendit vakant është publikuar 1 herë, dhe është anuluar për arsye të mungesës së numrit të kërkuar të kandidatëve, procedura e konkursit mund të zhvillohet brenda kritereve të përcaktuara edhe me një kandidat.



ANEKSI 4

LËNDA: Kriteria të vlerësimit të kandidatëve për konkurim për vend të lirë pune për personel ndihmesakademik dhe administartiv në “dep ” _____”

pranë Fakultetit të _____

D. Personel “ndihmës akademik” dhe “administartiv”

KRITERE TË PËRGJITHSHME


I.	KRITERE ELIMINUESE
1.	Të zotërojë diplomë të ciklit të parë të studimeve dhe të ciklit të dytë në sistemin me/pa shkëputje nga puna.
2.	Nuk ka kufizime për moshën (deri në moshën e pensionit)
<i>Shënim: Në rast mosplotësimi të kriterëve më sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.</i>	

I. KRITERE TE VEÇANTA

II	KRITERE PËR VLERËSIMIN NË (PIKË) DHE RENDITJEN E KANDIDATËVE	Vlerësimi (pikë)
1	Zotëron diplomë të studimeve të ciklit të dytë M.Prof	7
	Zotëron diplome të studimeve të ciklit të dytë M.SH.	10
2	Të kenë përvojë pune në profesion	
	• Për çdo vit eksperiencë	2
3	Kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit:	
	• Kurs kualifikimi brenda vendit (i vërtetuar me dëshmi ose dokument tjetër, për çdo kurs 1 pikë))	1



	Kurs kualifikimi jashtë vendit (i vërtetuar me dëshmi ose dokument tjetër)	2
4	Aftësimi në programe kompjuterike, të cilat vërtetohen me dëshmi përkatëse.	2
5	Njohuri të gjuhëve perëndimore (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjis spanjisht, etj.) e vërtetuar me dëshmi .	
	Gjuha Angleze, Niveli i lartë ose i barabartë me A2.	5
	Gjuhë e tjera, Niveli ekuivalent me gjuhën angleze (pavarësisht numërit)	3
TOTALI PIKËVE 70 pikë		70
1	Intervista me gojë	30 pikë



ANEKSI V

LËNDA: Kriteria të vlerësimit të kandidatëve për konkurim për vend të lirë pune për personel ndihmes akademik dhe administativ pranë Drejtorisë të

D. Personel “ndihmës akademik” dhe “administativ”

KRITERE TË PËRGJITHSHME

I.	KRITERE ELIMINUESE
1.	Të zotërojë diplomë të ciklit të parë të studimeve dhe të ciklit të dytë në sistemin me/pa shkëputje nga puna.
2.	Nuk ka kufizime për moshën (deri në moshën e pensionit)
<i>Shënim: Në rast mosplotësimi të kriterëve më sipër dosja e aplikantit nuk duhet të pranohet.</i>	

I. KRITERE TE VEÇANTA

II	KRITERE PËR VLERËSIMIN NË (PIKË) DHE RENDITJEN E KANDIDATËVE	Vlerësimi (pikë)
1	Zotëron diplomë të studimeve të ciklit të dytë M.Prof	7
	Zotëron diplome të studimeve të ciklit të dytë M.SH.	10
2	Të kenë përvojë pune në profesion	
	• Për çdo dy vjet eksperiencë	2
3	Kurse kualifikimi brenda dhe jashtë vendit:	
	• Kurs kualifikimi brenda vendit (i vërtetuar me dëshmi ose dokument tjetër) (numër kursesh *pikët për secilin)	1

	Kurs kualifikimi jashtë vendit (i vërtetuar me dëshmi ose dokument tjetër) (numër kursesh *pikët për secilin)	2
4	Aftësimi në programe kompjuterike, të cilat vërtetohen me dëshmi përkatëse.	2
5	Njohuri të gjuhëve perëndimore (anglisht, italisht, gjermanisht, frëngjis spanjisht, etj.) e vërtetuar me dëshmi .	
	Gjuha Angleze, Niveli i lartë ose i barabartë me A2.	5
	Gjuhë e tjera, Niveli ekuivalent me gjuhën angleze (pavarësisht numërit)	3
TOTALI PIKËVE 70 pikë		70
1	Intervista me gojë	30 pikë